



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË  
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 15175 Prot

Lezhë, më 29 / 9 /2023

VENDIM

Nr. 38, Datë 28. 09. 2023

“PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN EKONOMIKE DERI NË 6 % PËR PERIUDHEN 01 – 31 GUSHT 2023 ”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të ligjit nr.139/ 2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore “ , të nenit 21, të ligjit nr 57/2019 “Për asistencën në Republikën e Shqipërisë”, të VKM nr. 597 dt.04. 09.2019 “Per përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, të VKM nr.565 dt. 09. 08.2006 " Për mbrojtjen e shtresave në nevojë nga rritja e çmimit të energjisë elektrike" i ndryshuar, të VKM nr. 8 datë 14. 01. 2015 " Për mbrojtjen e shtresave në nevojë për heqjen e fashës deri 300 KWH në muaj", nga materiali i paraqitur nga Drejtoria e Shërbimit dhe Kujdesit Social, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë;

Vendosi :

Miratimin e listës se familjeve për t’u trajtuar me ndihmë ekonomike me anë të fondit të kushtëzuar për bllok – ndihmën ekonomike për muajin **GUSHT 2023**.

- Tabelë përmbledhese sipas Njësive Administrative për trajtimin me ndihmë ekonomike me anë të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6% per muajin **GUSHT 2023**.

Nr	Bashkia Lezhë/Njësiti	Nr. i familjeve	Masa e ndihmës 6%	Nr. i familjeve që përfitojnë kompensim	Masa e Kompensimit	Shkolla	Totali i Përfituar
1	LFZHË	21	81,889	6	7,728		89,617
2	SHENKOLL	26	112,300	13	16,744		129,044
3	KALLMET	2	9,086	2	2,576		11,662
4	ZEJMEN	7	29,559	5	6,440		35,999
5	BALLDREN	7	31,976	3	3,864		35,840
6	SHENGJIN	7	24,449	1	1,288		25,737
7	UNGREJ	7	27,759				27,759
8	DAJÇ	6	37,818				37,818
9	KOLSH	12	66,643	1	1,288		67,931
10	BLINISHT	2	11,066	1	1,288		12,354
	<b>TOTAL</b>	<b>97</b>	<b>432,545</b>	<b>32</b>	<b>41,216</b>		<b>473,761</b>

SEKRETARI  
FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI  
NDUE LULI



145/15178/1 prot  
03.10.2023



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT LEZHË  
SEKTORI JURIDIK

Nr. 445/12 Prot.

Lezhë, më 03.10.2023

Lënda: Konfirmim vendimi

**KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË**

**Për dijeni : KRYETARIT TË BASHKISË LEZHË**

Bazuar në nenin 16 pika 2 gërma "b" të ligjit nr.107/2016, datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", ligjin nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", ligjin nr.57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë" VKM-në nr.597, datë 4.9.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", VKM-në nr.565, datë 09.08.2006 "Për mbrojtjen e shtresave në nevojë nga rritja e çmimit të energjisë elektrike" i ndryshuar, VKM-në nr.8, datë 14.01.2015 "Për mbrojtjen e shtresave në nevojë efekt të heqjes së fashës së konsumit të energjisë elektrike deri në 300 KWH në muaj" i ndryshuar, konfirmoj bazueshmërinë ligjore të vendimit nr.38, datë 28.09.2023 të këshillit të bashkisë Lezhë "Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6% për periudhën 01-31 gusht 2023".

**P R E F E K T I**

**Gjergj PRENDI**

